



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:190114

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05705135

KE.nr. 1397/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të paditësit Allmakes Global Service, me seli në Drenas, Parku i Biznesit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Valdrin Behrami, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” Sh.A., me seli në Prishtinë, rr. “Perandori Justinian”, nr. 69, me objekt kontesti kompensimi i dëmit material, vlera e objektit të kontestit e papërcaktuar, duke vendosur sipas parashtrësës së paditësit për tërheqjen e padisë, jashtë seancës, më datë 20.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se është tërhequr padia e evidentuar me numër KE.nr. 1397/22, e paditësit Allmakes Global Service, me seli në Drenas, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” Sh.A., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimi i dëmit material.

A r s y e t i m

Paditësi Allmakes Global Service, me seli në Drenas, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datën 26.08.2021, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “Scardian” Sh.A., me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj dëmin material.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë ka kaluar pranë Dhomave të Shkallës së Partë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, sipas kompetencës lëndore të kësaj gjykate.

Ndërsa, me datë 17.05.2024, paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar me anë të parashtresës ka njoftuar gjykatën se tërheqë kërkesëpadinë pasi që në këtë çështje juridike palët kanë arritur marrëveshje për kompensimin e dëmit.

Nga sa më sipër, gjykata duke vepruar sipas parashtresës së paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 1397/22, datë 20.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.